

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“EMRO.AG”SH.P.K**

Sot, me datë 04/06/2024 në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, themeluesi:

**EMRUSH AHMETI, shtetas Kosovar, lindur në Stanishor, lindur më 30 /01/1964, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ID nr. 2308494 dhe Nr.Personal 1500080562,**

**në cilësinë e ortakut themelues ka vendosur të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar , e emërtuar “EMRO.AG ” SH.P.K**

**KREU I**

**NENI 1**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

- 1.1 Krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, sipas ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe aktet tjera ligjore që janë në fuqi.
- 1.2 Akti i themelimit është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, rregullohen nga statuti, nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacioni shqiptar si dhe në kontrata respektive.

**NENI 2**

**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

2.1. Shoqëria mban emrin “ **EMRO.AG** ” Sh.p.k dhe është person juridik shqiptar.

2.2. Shoqëria “ **EMRO.AG** ” Sh.p.k (ne vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm :

**EMRUSH AHMETI, shtetas Kosovar, lindur në Stanishor, lindur më 30 /01/1964, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ID nr. 2308494 dhe Nr.Personal 1500080562,**

dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij akti themelimi.

**NENI 3**

**SELIA E SHOQËRISË**

3.1. Shoqëria e ka qendrën në “ **Tale 2 , Njesia Administrative Shenkoll, Ndertese 1 kat , kati I pare, në pasurinë me nr. 25/82, zona kadastrale 3968** “dhe gëzon të drejtën për të hapur filiale ose degë të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj.

3.2. Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësitë do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

**NENI 4**



## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

4.1. Shoqëria "EMRO.AG" Sh.p.k do të ushtrojë aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj pranë Q.K.R. .

### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

5.1. Shoqëria është themeluar për të vepruar me këtë objekt veprimtarie:

- Shitje dhe Blerje të Pasurive të Luajtshme dhe të Paluajtshme

5.2. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.

### NENI 6

#### PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE

6.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësise së ortakëve.

6.2. Ortakët që marrin pjesë në këtë shoqëri, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që vetë ata kanë nënshkruar, gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të saj.

## KREU II

### NENI 7

#### KAPITALI I SHOQËRISË

7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 leke (Dhjetemijë) lekë dhe përbëhet nga numri i kuotave 1 (një) dhe me vlerë nominale dhe me përqindje si më poshtë:

**EMRUSH AHMETI** - vlerë nominale 10.000 lekë / përqindje 100 % / 1 (një) kuote.

Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues. Kuota e Pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emruara dhe të pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Cdo kuotë i takon e drejta e një vote.

### NENI 8

8.1. Në librin e llogarisë që do të krijohet në shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar do të shënohet kapitali derdhur nga ortakët e shoqërisë. Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit fillestar të shoqërisë përcaktohet sipas rregullave të përcaktuara në statutin e shoqërisë me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### NENI 9

#### SHLYERJA E KAPITALIT THEMELTAR

9.1. Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortakët e shoqërisë.

## KREU III

### NENI 10

#### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:



**10.1.Asambleja e Përgjithshme.**

Administratori ose administratorët e shoqërisë.

**10.2.**Modalitetet dhe procedurat e emërimit, shkarkimit, kohëzgjatja e mandatit dhe kompetencat e administratorit caktohen në statutin e shoqërisë.

**10.3.** Administratori i shoqërisë emërohet **EMRUSH AHMETI**, shtetas Kosovar, lindur në Stanishor, lindur më **30 /01/1964**, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ID nr. 2308494 dhe Nr.Personal 1500080562, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat **5 vjeçar**.

**NENI 11**

**TË PËRGJITHSHME**

**11.1.**Shoqëria do të ketë simbolet dhe vulën e saj personale, ku janë shënuar inicialet e saj të emërimit të saj. Fillimin e aktivitetit të saj tregtar kjo shoqëri e lidh me regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe me marrjen e NIPT-it përkatës.

**NENI 12**

**12.1.**Dispozita më të hollësishme janë parashikuar në Statutin e kësaj shoqërie, i cili shpreh vullnetin e lirë të themeluesve.

**NENI 13**

**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**13.1.**Ky Akt-Themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike.

**ORTAKUI VETËM**

**EMRUSH AHMETI**

*Emrush Ahmeti*  
*[Signature]*